



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr.            prot.

Tiranë, më 14.07.2022

Lënda: Kthim përgjigjeje kërkesës suaj për informacion.

ZNJ. B                    C

TELEVIZIONI “V”                    P

Adresa postare: Rruga “...  
Të dhënat e kontaktit: e-mail: ...

**E nderuar znj. C**

Në përgjigje të kërkesës juaj për informacion, datë 5.7.2022, e cila është protokolluar pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me nr.            prot., datë 6.7.2022, ju informojmë se:

Nga fillimi i veprimtarisë së Komisionit dhe deri më 30 qershor 2022, janë dorëhequr nga detyra, sipas nenit G të Aneksit kushtetues, **80** subjekte rivlerësimi, për të cilët është vendosur ndërprerje e procesit, nga të cilët **49** janë gjyqtarë, **21** prokurorë, **2** ish- Inspektorë në KLD dhe **7** ndihmësve ligjorë, si dhe **1** ish-prokuror. Bashkëlidhur përgjigjes, lutem gjeni listën me emrat subjekteve të dorëhequr me vendim të KPK-së. Për t’u informuar me statistika të tjera të përditësuara, ju mund të aksesoni lirisht faqen tonë zyrtare, kategoria “Statistika” <https://kpk.al/statistika/>.

Në lidhje me arsyen e dorëheqjes së subjekteve, ju mund t’i referoheni vendimeve të cilat janë të arsyetuara me shkrim në faqen tonë zyrtare, kategoria “Vendime” <https://kpk.al/vendime/>.

Duke ju uruar punë të mbarë, shpresojmë t’ju kemi ndihmuar me informacionin.

SEKRETARI I PËRCJHTSHËM

Edmond Bervani

